



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani i Elezit

01/ Nr. 168 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008 nenit 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2012 merr këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2012

I

Miratohet plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2012.

II

Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2012 përbën detyrat, dhe përgjegjësit e punës së drejtorive të Komunës në bazë të ligjeve aplikative dhe Statutit të Komunës.

III

Vendimi hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria e Politikave Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 01.02.2012

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

